

Formular për SYLLABUS të Lëndës Menaxhimi i medias

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i medias
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i III-rë, semestri i I-rë
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Ligjërata: e martë 16-18 Ushtrime: e mërkurë 14-16 Asistent: MA Faton Ismajli Ph.D cand.
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. ass. dr. Bajram Kosumi
Detajet kontaktuese:	bajram.kosumi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Lënda përmban teoritë themelore të menaxhimit. Pjesa kryesore mbështetet në menaxhimin e organizmave medialë: menaxhimi i medieje publike dhe private, menaxhimi i medieje elektronike dhe atyre të shtypura, menaxhimi i medieje ditore dhe atyre javore. Një pjesë e kursit fokusohet në menaxhimin e procesit të teknologjisë së lajmit: çka ndodhë me lajmin kur ai mbërrin në medium? Këtu ka edhe një pjesë për rolin që kanë në gazetë redaktorët dhe kryeredaktorët.
Qëllimet e lëndës:	Ligjërimi i kësaj lënde ka për qëllim që studentëve të vitit të tretë t'u japë njohuritë bazike për menaxhimin e medias. Menaxhimin e medias në këtë kurs i qasemi nga aspekti teorik e praktik. Aspekti teorik: 1. Si organizohet menaxhmenti i një media? Si organizohet dhe si funksionon redaksia e saj? Çka janë dhe cilat janë rubrikat e medias, si organizohen dhe si unifikohen ato në një tërësi? Cila është teknologjia e prodhimit të lajmit, nga ideja e lajmit e deri te shtypja e tij? Si bëhen faqet e një gazete? Aspekti praktik: 2. Do të merret në shqyrtim një shembull nga një gazetë ditore në Kosovë, për të parë si funksionon menaxhmenti e redaksia dhe si organizohen ndaras e në tërësi rubrikat e saj. 3. Do të merret në shqyrtim shembulli i Radio Televizionit Publik të Kosovës, për të parë si funksionon menaxhmenti e redaksia dhe si organizohen ndaras e në tërësi rubrikat e tij. 4. Do të merret në shqyrtim një shembull nga një gazetë on-line, për të parë si funksionon menaxhmenti e redaksia dhe si organizohen ndaras e në tërësi rubrikat e saj. 5. Do të merret në shqyrtim një shembull nga një agjenci lajmesh, për të parë si funksionon menaxhmenti e

	redaksia dhe si organizohen ndaras e në tërësi rubrikat e saj. Qëllimi i këtij kursi është t'u japë studentëve dijen e duhur për të kuptuar se si funksionon menaxhmenti i medias, redaksia dhe rubrikat e saj, në mënyrë që pas studimeve, kur ata të fillojnë punën si gazetarë, të jenë të familjarizuar me menaxhmentin dhe me teknologjinë e prodhimit të gazetës e të lajmit. Po ashtu seminari i përbashkët për bërjen e redaksisë dhe organizimin e një gazete, mbushjen e saj me tekste gazetare etj. ka për qëllim që edhe praktikisht t'i aftësojë studentët në praktikumin e dijeve për menaxhimin e medias.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studenti: Kupton menaxhimin e medias dhe organizimin e saj në rubrika, ndarjen e punës midis redaktorëve dhe detyrat e gazetarëve. Kupton ndarjen dhe përgatitjen e faqeve të një gazete ditore. Kupton organizimin dhe funksionimin e një redaksie të gazetës së shkruar. Kupton organizimin dhe funksionimin e një redaksie të gazetës on-line. Kupton organizimin dhe funksionimin e një redaksie të agjencisë së lajmeve. Kupton menaxhmentin e medias private dhe medias publike. Kupton organizimin dhe funksionimin e menaxhmentit, të redaksisë, të rubrikave dhe të skemës programore të Radio Televizionit Publik të Kosovës. Kupton teknologjinë e zgjedhjes dhe të procesit nëpër të cilin ecën lajmi nga shkrimi i tij e deri te shtypja e tij. Kupton rolin e marketingut për gazetën dhe shpërndarjen e faqeve të marketingut nëpër gazetë. Kupton mundësitë e mëdha të gazetës për botimin e shtojcave të veçanta. përgatitet të familjarizohet në një redaksi të medias dhe të orientohet brenda rubrikave të medias. Aftësohet të organizojë menaxhment të medias, të organizojë redaksinë e një medie, të shpërndajë punën te redaktorët dhe te gazetarët, të redaktojë tekstin gazetar dhe të redaktojë faqen e gazetës.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	20 min	15	5
Kollokfiume,seminare	10	1	10
Detyra të shtëpisë	0.5	15	7.5
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30

(në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim	3	1	3
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	1	5
Projektet,prezentimet ,etj	1	1	1
Totali			121.5 orë= 5 ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënia në këtë lëndë është e kombinuar: ligjërata udhëzuese dhe ligjërata për shembujt konkretë. Në ligjërata përdoret metoda interaktive, por pjesa kryesore mbulohet nga shpjegimi i shembujve konkretë. Në fund të ligjëratave studentët marrin detyra që duhet t'i bëjnë në shtëpi dhe t'i diskutojnë në orën e ushtrimeve. Ligjëratat dhe analizimi i shembujve konkretë përqendrohen në dy aspekte: 1. t'ua mësojë studentëve funksionimin dhe menaxhimin e medias në të gjitha proceset kyçe; dhe 2. t'i aftësojë ata që të familjarizohen me industrinë e bërjes së medias dhe të praktikojnë menaxhimin e medias. Shembujt konkretë dhe ligjëratat për ta janë: diskutime për mënyrën e menaxhimit, të organizimit të redaksisë, të rubrikave, të faqeve e të sektorëve të një mediumi, në radhë të parë të gazetës ditore, të RTK-së, të gazetës on-line, të agjencisë së lajmeve etj. Do të ketë edhe një ushtrim [temë seminari] në bërjen e një gazete. Ushtrimi do të bëhet në ekipe.		
Metodat e vlerësimit:	1. Në javën 11, 12 dhe 13, studentët do të punojnë në grup ushtrimin për bërjen e një gazete: që nga formimi i redaksisë deri te botimi i saj. Do të vlerësohet puna e secilit student individualisht. 2. Në javën e 14 studentët kanë test me shkrim në formë pyetje-përgjigje dhe mbarështim i temave të kërkuara. 3. Vlerësimi i fundit bëhet përmes pyetjeve e përgjigjeve gojore. Vlerat e pikëve: 50-60 = 6 61-70 = 7 71-80 = 8 81-90 = 9 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Shyqyri Llaci, <i>Manaxhimi</i>, AlbPaper, Tiranë, 2008. 2. Andri Koxhaj, Florian Tomini, <i>Manaxhimi i komunikimit</i>, botim i autorëve, Tiranë, 2006. 3. Francesco Pira, <i>Si të krijosh një zyrë shtypi</i>, ISHM,. Tiranë, 2002.		

	4. Riccardo Stagliano, <i>Gazetaria 2.0/Të merresh me informacion në kohën e internetit</i>, ISHM, Tiranë, 2004. 5. Melvin Mencher, <i>Raportimi dhe shkrimi i lajmit</i>, Tiranë 1998. [kapitujt: 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24].
Literatura shtesë:	1. <i>Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore</i>, redaktuar nga Malcolm F. Mallet (përkthyer nga Ilir Ikonimi), Dituria, Tiranë, 2003. [kapitujt: 9, 10, 14, 17, 19, 23, 24]. 2. Stjepan Malović, <i>Novine</i>, Sveučilišna Knjižara, Zagreb, 2003. [pjesët: III dhe V]. 3. http://journalism.about.com/lr/editing_structure/What_Edithors_do/ [Tony Rogers, Journalism Guide [Editing Struktura. Newspaper editing. What Edithors do?], version elektronik.]

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Studenti është i obliguar të vijojë ligjërata dhe ushtrime, nëse studenti nuk vijon mësimin me rregull (mungon më shumë se tri here atëherë nuk merr nënshkrimi. Plagiatura në provime është e dënueshme; studenti merr note negative. Vlejnë kodi e mirësjelljes si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësin.	
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Njoftim me metodologjinë e punës. Njoftim i studentëve me përmbajtjen e lëndës. Çështje të nocioneve themelore të menaxhimit të medias. Media si informim[veprimtari intelektual] dhe si fitim [biznes].
<i>Java e dytë:</i>	Menaxhimi. Teoritë e menaxhimit. Menaxhimi medial.
<i>Java e tretë:</i>	Funksionet e menaxheriale
<i>Java e katërt:</i>	Ç'është redaksia? Redaksia e gazetës së shkruar.
<i>Java e pestë:</i>	Rubrikat. Rubrikat dhe faqet e gazetës së shkruar. [Vizitë studimore në një redaksi të gazetës së shtypur. Tema: teknologjia e prodhimit të lajmit nga ideja e lajmit deri te botimi].
<i>Java e gjashtë:</i>	Menaxhmenti i medias private dhe medias publike. Menaxhmenti, redaksia dhe rubrikat e Televizionit Publik të Kosovës. Skema programore e RTK-së. [Vizitë studimore në një radio apo TV. Tema: skema programore, struktura dhe sistemi organizativ].
<i>Java e shtatë:</i>	Menaxhmenti i medias private dhe medias publike.

	Menaxhmenti, redaksia dhe rubrikat e Televizionit Publik të Kosovës. Skema programore e RTK-së. [Vizitë studimore në një radio apo TV. Tema: skema programore, struktura dhe sistemi organizativ].
<i>Java e tetë:</i>	Planifikimi i gazetës
<i>Java e nëntë:</i>	Teknologjia e zgjedhjes, e redaktimit dhe e dorëzimit në shtyp të lajmit.
<i>Java e dhjetë:</i>	Marketingu dhe shitja.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Fletushkat dhe flajerët
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Seminar vlerësues. Detyrë grupe: Përgatitja e një gazete Krijimi i redaksisë. Ndarja e detyrave për gazetarët. Hulumtimi i temave. Shkrimi dhe redaktimi i temave. Botimi i gazetës [në kushtet e kabinetit të fakultetit].
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Seminar vlerësues. Detyrë grupe: Përgatitja e një gazete Krijimi i redaksisë. Ndarja e detyrave për gazetarët. Hulumtimi i temave. Shkrimi dhe redaktimi i temave. Botimi i gazetës [në kushtet e kabinetit të fakultetit].
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Test vlerësues i dijes së arritur të studentëve. Testi bëhet me shkrim, në formë pyetje-përgjigje, dhe në formë mbarështimi të temës së kërkuar nga profesori.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Rezultatet e testit.